

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Një strategji kombëtare dhe plan veprimi për zhvillimin e bibliotekave publike shqiptare në Shoqërinë e Informacionit

Robert Davies - *Drejtor, ISTAR Networks. Londër*
Ramazan Vozga - *Menaxher, Qendra e Trajnimit Bibliotekar*

Tiranë 2007

A Bibliotekat publike në Europë

Një rrjet efektiv bibliotekash publike ekziston në vendet europiane si një mjet i rëndësishëm për zhvillim kulturor, social dhe ekonomik. Me shpejtësi ato po marrin tipare të reja që po e zgjerojnë statusin e tyre si institucione të rëndësishme brenda komuniteteve lokale.

Përveç kryerjes së detyrave më tradicionale, që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe shfrytëzimin e kulturës, mbështetjen e leximit dhe të vetëedukimit të qytetarëve, bibliotekat publike tani janë:

- duke punuar në partneritet me institucionet arsimore, organizatat e biznesit dhe autoritetet lokale për t'i ndihmuar në arritjen e objektivave të tyre;
- duke siguruar trajnim në përvetësimin e teknologjive digjitale për të vetëpunësuarit, ata që punojnë nëpër shtëpi, bizneset e vogla dhe për ata që janë përfshirë në të mësuarit në distancë;
- duke siguruar gjithnjë e më tepër akses në Internet për qytetarët.

Sipas të dhënave të *Libecon2000* në 28 vendet europiane të përfshira në këtë studim bibliotekat publike numërojnë 118 milion anëtarë të regjistruar dhe 2.2 bilion vizita për çdo vit në 69.000 pika shërbimi statike. Këto biblioteka ofrojnë për publikun më tepër se 100.000 poste kompiuterash. Mjaft biblioteka publike tani gjithashtu shpërndajnë shërbimet e tyre aty ku banojnë dhe punojnë njerëzit përmes World Wide Web-it.

B Strategjitë e zhvillimit të bibliotekave publike në Europë

Prej kohësh është ndër nevoja e ndërmarrjes së një vargu iniciativash për rritjen e rolit të bibliotekave publike si institucione kyç të Shoqërisë së Informacionit, gjë që do të ndihmonte për zhvillimin e një shoqërie kohezive dhe për një ekonomi konkurruese. Deklarata e nismës PubliCA të Bashkimit Europian në konferencën e Kopenhagës (tetor 1999) nënvizon rolin e bibliotekave publike në mbështetje të:

- *demokracisë dhe qytetarisë*
- *zhvillimit ekonomik dhe social*
- *të mësuarit gjatë gjithë jetës*
- *diversitetit kulturor dhe gjuhësor*

Gjithashtu në nisma të tjera paneuropiane Bashkimi Europian ka theksuar rëndësinë e krijimit të site-ve në Internet me informacion për të drejtat qytetare dhe shërbimet publike. Ai ka caktuar si objektiv që të ngrihen pika për akses publik në Internet si dhe të trajtohen on-site, kryesisht përmes bibliotekave publike, të gjitha komunitetet për njohjen e shoqërisë së informacionit dhe të teknologjisë së saj. Vlera e bibliotekave si një "hapësirë neutrale" ideologjikisht dhe politikisht në mbështetje të gjithëpërfshirjes sociale është gjithashtu gjerësisht e njohur.

Këshilli i Europës e ka shndërruar aksesin lokal për qytetarët në trashëgiminë kulturore përmes bibliotekave publike që përdorin teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në një të drejtë themelore për lirinë e shprehjes dhe për informacion. Ai ka theksuar se zhvillimi i një strategjie të qartë, brenda një kuadri ligjor të përshtatshëm, është domosdoshmëri për përparimin e rrjetit kombëtar të bibliotekave publike të vendeve anëtare të tij.

C Sfida teknike dhe profesionale për bibliotekat publike

Për krijimin e një vizioni të ri për bibliotekat publike, menaxherët dhe stafi i tyre po përballen me një varg sfidash që kanë të bëjnë me përvetësimin e njohurive teknike dhe profesionale që u nevojiten për zhvillimin dhe nxitjen e shërbimeve bibliotekare të bazuara në teknologjitë e reja informatike. Ata duhet të njohin më mirë se deri tani strategjitë financiare dhe mundësitë e shumëllojshme të financimit si dhe të kenë qëndrime dhe aftësi menaxheriale më dinamike.

Në pikëpamje të përcaktimit të politikave të shërbimit, ata duhet të zhvillojnë dhe të përcaktojnë një kuptim të qartë të kontributit potencial të bibliotekave publike për çështje të tilla themelore shoqërore si të mësuarit gjatë gjithë jetës, gjithëpërfshirja sociale dhe demokracia. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë dhe të vlerësojnë realizimin e shërbimeve bibliotekare, përfshirë edhe ato të siguruar në mënyrë elektronike.

Në pikëpamje teknike ata duhet të njohin gjithnjë e më mirë aspekte të tilla si shfrytëzimi i burimeve në Internet, përshkrimi dhe indeksimi i këtyre burimeve, digjitalizimi, ruajtja digjitale, plotësimi i kërkesave për akses, lejimi dhe të drejtat për akses në valët dhe infrastrukturën e telekomunikacionit.

D Bibliotekat publike në Shqipëri: pika nisëse

Shqipëria ka një rrjet relativisht të gjerë bibliotekash publike, kapaciteti, niveli dhe mundësitë e të cilave ndryshojnë që nga koleksionet e vogla librore me shfrytëzim dhe shërbim të kufizuar në çdo ndarje

administrative lokale deri në bibliotekat e mëdha në qytetet kryesore të vendit. Fillimisht ato kanë qenë organizuar për përdorim me fonde të mbyllura, në të cilat lexuesi kishte akses vetëm nëpërmjet skedarëve. Vitet e fundit, megjithëse ndihet mungesa e hapësirës, shumica e tyre po punon që t'i organizojnë koleksionet mbi bazën e fondeve të hapura.

Shërbimet kryesore që bibliotekat publike shqiptare ofrojnë momentalisht kufizohen në:

- shfrytëzimin e trashëgimisë kombëtare dhe të huaj të shtypur
- huazimin (e materialeve të shtypura)
- organizimin e veprimtarive kulturore
- organizimin e mbledhjeve dhe takimeve të ndryshme
- ekspozita dhe veprimtari të tjera

Në Shqipëri roli i bibliotekave publike si mbledhëse të informacionit dhe si pika shfrytëzimi të tij është ende në zhvillim e sipër dhe arritjet e revolucionit në fushën e sigurimit të informacionit elektronik sapo kanë nisur të shfrytëzohen. Fillimisht vëmendje më e madhe i duhet kushtuar rritjes së ndërgjegjësimit publik për shërbimet që mund të ofrohen në bibliotekat publike duke shfrytëzuar mundësitë e tyre për të stimuluar shprehitë e kërkimit të informacionit të lexuesit. Nga ana tjetër, vetë bibliotekat publike duhet t'u japin përparësi shërbimeve të reja, sepse vetëm pak prej tyre përpiqen të sigurojnë informacion kyç për publikun.

Për t'iu përgjigjur siç duhet kërkesave të shndërrimeve shoqërore, bibliotekat publike shqiptare duhet të përgatiten për rivlerësimin e rolit dhe të mundësive të tyre si dhe për rishikimin e shërbimeve të tyre, të cilat duhet të fokusohen në mbështetjen e komuniteteve lokale sepse qytetet në të cilat ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre po përjetojnë probleme të mëdha sociale dhe ekonomike që kanë të bëjnë me papunësinë, standardet e arsimit, fluksin e popullsisë nga zonat rurale etj. Gjithashtu, krijimi i shërbimeve të veçanta të informacionit në mbështetje të veprimtarive të biznesit lokal, veçanërisht të SME-ve, duhet të jetë një përparësi.

Përgjithësisht sfidat që duhet të përballojnë bibliotekat tona publike mund të përmbledhen si më poshtë:

- mungesa e një strategjie kombëtare
- mbështetje politike e zbehtë
- probleme financiare
- mungesa e një stafi të trajnuar
- ndërtesa të papërshtatshme dhe mungesë hapësire
- akses i paktë në rrjete kompiuterike
- imazh social i varfër.

Për kapërcimin e këtyre mungesave është jetik krijimi i vendimmarrësit në nivel kombëtar dhe lokal i një koncepti modern mbi rëndësinë dhe vlerën e bibliotekave publike, në mënyrë që ata të bëjnë të tyren dhe të përkrahin çështjen e bibliotekave publike, duke i parë ato si një

investim dhe jo thjeshtë si shpenzim. Sigurimi i fondeve financiare të nevojshme për shërbimet bibliotekare është padyshim tepër me rëndësi. Buxhetet vjetore vërtetë kanë ardhur duke u rritur nga shteti, por niveli i financimit mbetet ende i ulët. Në situatën e përgjithshme ekonomike, bibliotekave publike u shtrohet si detyrë të kërkojnë burime të ndryshme financimi.

E Mbështetja dhe zhvillimet strategjike deri tani

Shqipëria po bën reforma të rëndësishme demokratike me qëllim që t'i bashkohet komunitetit ndërkombëtar pas dekada vetëizolimi. Në sferën e kulturës, p. sh., para pak kohësh është miratuar Ligji për Librin, i cili i sheh politikat e zhvillimit në këtë fushë në një perspektivë e re dhe ndërsektoriale. Po ashtu, ekzistenca dhe funksionimi i bibliotekave garantohet nga Ligji për Bibliotekat, miratuar në vitin 2000, ndërkohë që punohet për reformimin e rregulloreve, udhëzësve, metodikave etj. të tyre.

F Objektivat e projektit

Për të kapërcyer sfidat dhe pengesat që u përmendën më lart janë të domosdoshme një politikë qeveritare dhe një strategji kombëtare mbështetëse, të cilat deri më sot kanë munguar. Ndaj ky projekt synon të zhvillojë një strategji kombëtare dhe nisma praktike pilot në fushën e bibliotekave publike në Shqipëri. Një gjë e tillë është e domosdoshme në qoftë se duam që ato të zhvillohen sipas standardeve europiane.

Projekti është strukturuar në mënyrë të tillë që t'u krijojë mundësi organizmave financuese, kombëtare dhe ndërkombëtare, të mbështesin punën e tij sipas fazave, nëse kjo është e nevojshme. Ai synon të nxisë zhvillimin e bibliotekave publike nëpërmjet futjes në to të shërbimeve të reja prej të cilave do të përfitojnë sektorë të ndryshëm ekonomikë, socialë dhe kulturorë.

Disa nga objektivat e përgjithshëm kyç të projektit janë:

- krijimi i një koncepti të ri për bibliotekat publike të vendimmarrësit në nivel kombëtar dhe lokal;
- përcaktimi i qartë i kompetencave dhe përgjegjësive mes autoriteteve respektive lokale dhe kombëtare;
- sigurimi nga ana e bibliotekave publike i shërbimeve të reja dhe të larmishme, përfshirë shërbimet e informacionit;
- rritja e përdorimit të teknologjisë informatike dhe e Internetit për shfrytëzimin e shërbimeve multimediale dhe për automatizimin;
- demonstrimi i përfitimeve prej investimeve në bibliotekat publike;

- ngritja profesionale e stafit dhe e menaxherëve të bibliotekave publike në mënyrë që ata të jenë në gjendje të realizojnë shërbimet e reja bibliotekare;
- krijimi i një vargu paketash të digjitalizuara me informacion në gjuhë shqipe në interes të qytetarëve për t'u shpërndarë përmes bibliotekave publike;
- rritja e vëmendjes për të qenë më efektivë në drejtim të planifikimit dhe tërheqjes së fondeve financiare;
- lidhje më të gjera dhe mbështetja në komunitetin e bibliotekarëve europianë si dhe në organizmat ndërkombëtarë, Bashkimin Europian, Komisionin Europian, IFLA-n (Federata Botërore e Bibliotekave) etj.;
- përfshirja e bibliotekave dhe e bibliotekarëve shqiptarë në projekte të përbashkëta rajonale dhe europiane.

G Plani i punës i projektit

Bibliotekat publike kanë potencialin e duhur për të kryer mjaft funksione. Por plani i punës i këtij projekti është konceptuar në mënyrë të tillë që të jetë i përballueshëm dhe i mbështetur në burimet financiare ekzistuese ose të pritëshme. Ai synon të përqendrohet në ato çështje që kanë përparësi dhe që do të hapin rrugë të reja për zhvillimet e ardhshme.

Faza 1 *Strategjia dhe prioritetet*

Objektivat

- Përcaktimi i prioriteteve, strategjisë dhe i një plan veprimi për zhvillimin e bibliotekave publike shqiptare në mbështetje të politikave kombëtare.
- Trajtimi i problemeve të infrastrukturës (p.sh. sigurimi i frekuencave) të nevojshme për funksionimin e shërbimeve bibliotekare parësore.
- Sigurimi i burimeve të mbështetjes financiare për implementimin e secilit element të strategjisë.

1.1 Përgatitja e strategjisë

- Shqyrtimi i gjendjes ekzistuese: sektori i studimit, me asistencë të huaj teknike, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë mbi bibliotekat publike dhe potencialin e tyre për zhvillim.

Rezultati (01): Raport me rekomandime

- Shqyrtimi i përvojës më të mirë të vendeve të tjera të rajonit dhe kudo gjetkë në Europë.

Rezultati (02): Raport me rekomandime

1.2 Konferencë multi-sektoriale strategjike që do të përfshijë përfaqësues të:

- ministrive përgjegjëse për sektorët e kulturës, arsimit, punësimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale;
- bashkive/autoriteteve lokale;
- donatorëve/financuesve të mundshëm vendas dhe të huaj.

Rezultati (03): Rekomandime të konferencës për qeverinë; marrëveshje donacionesh.

1.3 Krijimi i një grupi kombëtar drejtimi ndërrikasterial

Rezultati (04): Rekomandime për veprim sipas çështjeve 1.1-1.3

1.4 Hartimi i një plan veprimi pesëvjeçar dhe i kostos së tij si dhe i një programi nismash për të gjitha bashkitë duke i parë bibliotekat si pika për:

- akses në Internet
- trajnimin në teknologjitë digjitale
- informacion për punësim
- demokraci on-line
- të mësuarit gjatë gjithë jetës për të rriturit
- mbështetje për shkollat
- mbështetje me informacion e biznesit lokal
- shërbime sociale
- shëndetësi
- njohuri juridike për qytetarët
- kulturë
- libra dhe lexim

Rezultati (05): Dokumenti programor qeveritar ose *'White Paper'*.

1.5 Workshope të shqyrtimit strategjik në vitin e dytë dhe të tretë.

Rezultati (06): Strategji e përmirësuar duke marrë në konsideratë rezultatet e veprimtarive pilot.

1.6 Krijimi dhe trajnimi i grupit kombëtar për hartimin e projekteve për bibliotekat publike

- Workshop për hartimin e projekteve.
- Identifikimi i financuesve dhe programeve për projekte në të cilat mund të marrë pjesë sektori i bibliotekave publike shqiptare [p.sh. për të siguruar sisteme të automatizuara të menaxhimit bibliotekar].
- Programimi i punës për hartimin e propozimeve.

Rezultati (07): Përzgjedhje projektsh për organizmat financues vendas dhe europianë në mbështetje të prioritetëve të përcaktuara për zhvillimin e bibliotekave tona publike.

Faza 2 *Pilotimi i shërbimeve të reja bibliotekare dhe monitorimi i rezultateve që do të arrihen*

Objektivat:

- Nxitja e interesit dhe besimit në mundësitë e bibliotekave publike për të siguruar shërbime të reja të dobishme dhe të rëndësishme për qytetarët shqiptarë, veçanërisht përqendrimi në aksesin në Internet dhe në trajnimin për përvetësimin e teknologjive digjitale.
- Krijimi i tre shërbimeve të reja pilot të bazuar në teknologjinë informatike [një në çdo vit] në biblioteka publike të tre rajoneve të ndryshëm të Shqipërisë, duke u dhënë mundësi bibliotekave të tjera të përfitojnë nga shembulli i tyre.

[Në çdo bibliotekë pilot]

- 2.1 *Marketingu dhe shqyrtimi i kërkesave të përdoruesve*
- 2.2 *Planifikimi i punëve dhe parashikimi financiar*
- 2.3 *Specifikimet teknike*
- 2.4 *Trajnimi*
- 2.5 *Prokurimi dhe instalimi i pajisjeve*
- 2.6 *Promovimi*
- 2.7 *Fillimi i shërbimeve*
- 2.8 *Monitorimi dhe vlerësimi*

Rezultati (08): Shërbime pilot të suksesshme dhe evidentimi i faktorëve të suksesit.

Faza 3 *Hartimi i një programi informacioni shqip të digjitalizuar dhe i një gateway në bibliotekat publike me informacion në gjuhën shqipe për qytetarët*

Objektivat:

- Instalimi në bibliotekat pilot dhe të tjera i softit të gateway-it që do të lejojë që burimet e informacionit në gjuhën shqipe të kërkohen dhe përdoren rregullisht prej qytetarëve.
- Zgjerimi dhe pasurimi i sasisë së informacionit në gjuhën shqipe të vlefshëm për qytetarët dhe krijimi i mundësisë që ai të gjendet lehtësisht në Internet.

3.1 Identifikimi i përmbajtjeve të kompiuterizuara ekzistuese në gjuhën shqipe (web site, database, dokumente të punuara në word etj.).

3.2 Identifikimi i zbrazësive për informacion të rëndësishëm për qytetarët.

3.3 Plan veprimi për përkthimin dhe krijimin e web-eve që mundësojnë informacionin (p.sh. për turizmin, biznesin lokal, arsimin dhe shërbimet trajnuese).

3.4 Workshop që do t'i paraprijë adoptimit dhe implementimit të standardeve të metadata-ve për informacionin e digjitalizuar.

3.5 Blerja e licensave dhe instalimi i softit të gateway-it fillimisht në bibliotekat pilot.

Rezultati (09): Hyrje në informacionin e zgjeruar në gjuhën shqipe të instaluar në bibliotekat publike kryesore.

Faza 4 Trajnimi për aftësim profesional

Objektivat:

- Rritja e numrit të menaxherëve të bibliotekave publike që do të kenë kontakt me përvojat rajonale pozitive për sigurimin e shërbimeve bibliotekare publike me qëllim që ata të mund të menaxhojnë realizimin efektiv të këtyre shërbimeve në Shqipëri.
- Marrja e licensës, përkthimi dhe përdorimi në Shqipëri i një pakete ndërkombëtare trajnimi profesional të të mësuarit në distancë të fokusuar në përdorimin efektiv të teknologjive informatike dhe të Internetit për bibliotekat publike, që do të realizohet në Bibliotekën Kombëtare ose në mjedise të tjera.

4.1 Gjashtë qëndrime trajnuese njëjavore në vit të menaxherëve dhe të punonjësve të shërbimit të bibliotekave publike (përfshirë ata të bibliotekave pilot) në bibliotekat publike të Verias (Greqi) dhe Lubjanës (Slloveni).

Rezultati (10): Një numër i konsiderueshëm menaxherësh dhe punonjësish të bibliotekave publike do të rrisin njohuritë e tyre për mundësitë dhe kërkesat e sigurimit të shërbimeve të reja.

4.2 Identifikimi i tregut ndërkombëtar, licensimi, përkthimi dhe përdorimi i programit të trajnimit në distancë.

Rezultati (11): Të gjithë drejtuesit dhe stafi teknik i bibliotekave publike do të marrin pjesë në programet trajnuese të të mësuarit në distancë.

